

# **RAPORT I VLERESIMIT** **TE** **NDIKIMIT NE MJEDIS** **TE AKTIVITETIT**

**“Prodhim dhe shitje materialesh ndertimi dhe furre gelqere me gaz”**



**Subjekti:** “GURI BANI”

**Vendndodhja:** Fier,Zharrez

**Pergatiti materialin :** “Eko- Studio- Projekt” sh.p.k  
**Tirane, 2014**

## **HYRJE**

Aktiviteti njerezor qe zhvillohet ne çdo aspekt te vetin, perveç dobesive ne menyre te pashmangshme krijon dhe “produkte” qe ne perfundim mund te sjellin probleme per zhvillimin e qendrueshem te mjedisit. Pavaresisht nga vlerat dhe volumet edhe ne Shqiperi keto probleme vrojtohen dhe shoqeria e shteti kane synuar dhe vazhdojne te organizojne dhe orientojne kete proces. Ndotja e mjedisit nenkupton shkarkimet e cdo lloj mbetje nga pjese te materialeve te ndryshme ne uje , toke, ajer e cila shkakton ose mund te shkaktojne probleme mjedisore te perkoheshme ose te perhershme ne balancen ekologjike te tokes. Se bashku me zhvillimin e madh qe eshte bere ne industri te ndryshme ne menyre te ngjashme me te njejten shpejtesi eshte rritur edhe sasia e mbetjeve nga perdorimi i te mirave materiale. Mbetjet industriale dhe ato urbane te patrajuara , emetimet e gazeve te demshem ne atmosfere , perdorimi i kimikateve te reja pa marre parasysh demet qe mund ti sjellin mjedisit kane sjelle problemet mjedisore me te cilat ne perballemi ne ditet e sotme. Ndaj eshte e nevojshme qe shoqeria te ndergjegjesohet per ta mbajtur sa me paster mjedisin ku jetojme duke marre masat e duhura per trajtimin e mbetjeve si dhe emetimin e gazeve te demshem ne atmosfere qe gjenerohen nga zhvillimi i aktiviteteve te ndryshme. Materiali qe paraqitet trajton ndikimet ne mjedisin fizik dhe human te aktivitetit

**“Prodhim dhe shitje materiale ndertimi dhe furre gelqere me gaz ”.**

Raporti i *Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis* siguron qe ndikime mjedisore te rendesishme jane vleresuar dhe marre ne konsiderate ne menyre te kenaqshme ne planifikim, projektim dhe zbatim te projektit.

VNM perfshin gjithashtu parashikimin dhe planifikimin e masave zbutese te ndikimeve te projektit ne mjedisin fizik dhe social me qellim permiresimin e cilesise dhe qendrueshmerise se mjedisit. Mbrojtja e mjedisit, si nje sistem dinamik, duhet pare ne teresine e faktoreve natyror, dhe te veprimet njerezor qe ushtrohen mbi te. Ato kane nje efekt te fuqishem mbi kushtet e jeteses se popullsisë, dhe jane nje element baze per krijime te favorshme ekonomike.

Ne kete raport *Vleresimi Ndikimi ne Mjedis* eshte trajtuar aktiviteti **“Prodhim dhe shitje materiale ndertimi dhe furre gelqere me gaz ”.**

## **BAZA LIGJORE**

Relacioni u pergatit ne zbatim te akteve ligjore, dhe nenligjore Mjedisore :

- *Ligji Nr.10 431,date 09.06.2011 “ Per Mbrojtjen e Mjedisit”*
- *Ligji nr. 10 448 date 14.07.2011 « Per Lejet e Mjedisit »*
- *Ligji nr.10 440 date 07.07.2011 « Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis »*
- *Udhezimi nr.3 date 02.12.2013 « Per dokumentacionin e domosdoshem per te kerkuar leje mejdisore te tipit A,B dhe C per aktivitete te reja dhe ekzistuese »*
- *Urdhrin e ministrit nr. 146 dt. 8.5.2007 ”Per miratimin e listes se kuqe te flores dhe faunes”*
- *Udhezimin nr 8 dt. 27.11.2007 “Per nivelin kufi te zhurmave ne mjedisete te caktuara”*
- *Ligji nr. 9010 dt. 13.02.2003 “Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta”*
- *Ligji nr. 8897 dt. 16.05.2002 “Per mbrojtjen e ajrit nga ndotja”*
- *Ligji nr. 10 463 date 22.09.2011 “Per menaxhimin e integruar te mbetjeve”*
- *Vendim nr.805 date 4.12.2003 « Per miratimin e listes se veprimtarive qe ndikojne ne mjedis per te cilat kerkohet leje mjedisore »*
- *Ligj nr. 8094 date 21.03.1996 « Per largimin publik te mbeturinave »*
- *Udhezim nr.1 date 03.03.2009 « Per detyrat e organeve mjedisore per te siguruar pjesemarrjen e publikut dhe te OJF-ve mjedisore ne procesin e vleresimit te ndikimit ne mjedis »*
- *Udhezim nr.3 date 19.11.2009 ‘Per metodologjine e raportit te VNM’*

## 1. PERSHKRIMI I AKTIVITETIT

### ➤ *Profili i propozuesit*

Subjekti "GURI BANI" me administrator Z.GURI BANI eshte rregjistruar prane QKR ne date dt 28/09/2010, me numer NIPT-ti **K32811401N** per ushtrimin e aktivitetit "Prodhim dhe shitje material ndertimi dhe furre gelqereje me gaz".

Me pergatitjen e dokumentacionit perkates subjekti kerkon te pajiset me Leje Mjedisore te Tipit B sipas Udhezimit Nr.3, date 02.12.2013 « Per dokumentacionin e domosdoshem per te kerkuar leje mejdisore te tipit A,B dhe C per aktivite te reja dhe ekzistuese », per ushtrimin e kesaj veprimtarie.

### 1.1 Qellimi dhe karakteristikat fizike te projektit

Projekti i paraqitur nga subjekti "GURI BANI" ka per qellim prodhimin dhe tregtimin e gelqeres ne furre vertikale e cila perdoret si lendë e parë dhe si lendë ndihmëse në proceset e ndryshme teknologjike, si dhe te pasqyroje ndikimet e mundeshme ne shendet dhe mjedis gjate ketij aktiviteti . Guri gëlqeror ose shkurt gëlqerori është mineral që bënë pjesë në grupin e shkëmbinjve të sedimentuar dhe që përbëhet kryesisht prej karbonatit të kalciumit. Llojet më të pastra të gurit gëlqeror përmbajnë edhe deri në 99% CaCO<sub>3</sub> (karbonat kalciumi).

Gëlqerja si material lidhës prodhohet me zbrëthimin termik të gurit gëlqeror. Varësisht prej temperaturës së procesit të zbrëthimit termik dhe prej përbërjes së lëndës së parë natyrore, dallojmë disa lloje të gëlqeres. Nje synim tjetër i ketij relacioni eshte te percaktoje e rekomandoje masat teknike organizative per zbutjen e ndikimeve negative qe mund te krijohen gjate zhvillimit te aktivitetit.

Per te realizuar respektimin e mjedisit dhe per te ulur ndikimin e impaktit ne mjedis, shoqeria " GURI BANI" ka siguruar metoda, mjete dhe makineri bashkekohore per zhvillimin e aktivitetit.

Gjithashtu shoqeria "Guri Bani" si lende te para qe depoziton : Lendet e para qe depozitohen dhe tregtohen jane: çimento e cila sigurohet nga subjekte te tjera, sigurohet ruajtja e cilesise se çimentos nga demtimet eventuale nga agjentet atmosferike;lende te tjera llac,hekur,rere e permasave te ndryshme etj.

**1.2 Vendndodhja e aktivitetit**

Aktiviteti “GURI BANI” me veprimtari prodhim dhe shitje materiale ndertimi si dhe furre gelqere me gaz ndodhet ne fshatin Zharrez, Fier. Vendndodhja e aktivitetit tregohet nga planvendosja e objektit si me poshte:

